

VENDIM
Nr. 317, datë 18.5.2022

PËR CAKTIMIN E DITËS SË MËRKURË, DATË 25.5.2022, DITË PUSHIMI

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e ditës së mërkurë, datë 25.5.2022, ditë pushimi për punonjësit e administratë shtetërore, të institucioneve me seli në qarkun e Tiranës, me përjashtim të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, shërbimit zjarrfikës, dhe punonjësve të sistemit shëndetësor.
 2. Dita e punës e datës 25.5.2022 do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda këtij viti.
 3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama